COVID-19 PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE #7

Menaxhimi i pastrimit dhe dezinfektimit

Qëndrueshmëria e SARS-CoV-2 në aerosole dhe sipërfaqe të ndryshme

Lloji i sipërfaqes / aerosolit	Qëndrueshmëria	Gjysëm-jeta
Aerosol	Deri në 3 orë	1.1-1.2 orë
Çelik inox	Nga 48-72 orë	5.6 orë
Karton/letër	Deri në 24 orë	3.46 orë
Plastikë	Deri në 72 orë	6.8 orë
Bakër	Deri në 4 orë	0.7 orë

Burimi: Neeltje van Doremalen, 2020

Dezinfektuesit ose metodat e dezinfektimit për objektet e kontaminuara më tëzakonshme:

SARS-CoV-2 është i ndjeshëm ndaj:

- Rrezatimit ultraviolet
- Nxehtësisë (56 ° C për 30 minuta)
- Dezinfektuesve (për një minutë):
    - Eter
    - Etanol (62-75%)
    - Peroksidi i hidrogjenit 0.5%
    - Hipoklorit natriumi 0,1%
    - Dezinfektuesit që përmbajnë klor
    - Acidi peracetik
    - Kloroform
    - (Klorheksidina nuk mund ta inaktivizojë në mënyrë efektive SARS-CoV-2)

Aplikimet e rekomanduara

Duart: Sapun dhe ujë, dezinfektues me përmbajtje alkooli me tharje të shpejtë, dezinfektues që përmban klor, peroksid hidrogjeni

Lëkura: 0.5% dezinfektues me bazë jodi, peroksid hidrogjeni

Mukoza: 0,05% dezinfektues me bazë jodi

Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.

Për detaje dhe referenca mbështetëse, konsultohuni me dokumentin e plotë udhëzues në www.fip.org/coronavirus

Ky dokument bazohet në provat dhe rekomandimet në dispozicion të organizatave me reputacion në kohën e publikimit. Ai do të përditësohet kur njohuritë e reja bëhen të disponueshme. 26 Mars 2020.